

VENDIM
Nr. 110, datë 24.2.2021

PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE, NË BASHKITË SHIJAK DHE LEZHË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 25 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, të miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 563 607 000 (pesëqind e gjashtëdhjetë e tre milionë e gjashtëqind e shtatë mijë) lekë, për financimin e rindërtimit të banesave individuale për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para, në bashkitë Shijak dhe Lezhë, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Shijak i transferohet fondi, në masën 200 049 812 (dyqind milionë e dyzet e nëntë mijë e tetëqind e dymbëdhjetë) lekë, për rindërtimin e 69 (gjashtëdhjetë e nëntë) njësive individuale të banimit, për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para;

b) Bashkisë Lezhë i transferohet fondi, në masën 363 557 188 (treqind e gjashtëdhjetë e tre milionë e pesëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e tetëdhjetë e tetë) lekë, për rindërtimin e 125 (njëqind e njëzet e pesë) njësive individuale të banimit për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para.

2. Efekti financiar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, të përballohet nga shpenzimet e fondit të rindërtimit, të miratuar për vitin 2021, dhe u transferohet bashkive Shijak dhe Lezhë në formën e transfertës së pakushtëzuar.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Shijak dhe Lezhë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama